

# ***Kontestimi i Shtetësisë së Kosovës nga Gjyqtarët e EULEX-it: Ndërmjet Zbatueshmërisë së Ligjeve të Kosovës dhe Rregulloreve të UNMIK-ut***

**Kushtrim Istrefi\***

We, human beings and human societies, become what we think we are. If we have conflicting ideas of what we are, we become a puzzle to ourselves and to others. If we have no clear idea of what we are, we become what circumstances make us.

Philip Allot, *The Health of Nations*

## **Abstrakt**

*Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, organizatat ndërkombëtare qëndruan neutrale ndaj statusit të ri të krijuar në vend. Ky qëndrim krijoi një situatë paradoksale për misionet ndërkombëtare që operonin në Kosovë, në veçanti për gjyqtarët e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), të integruar në sistemin gjyqësor të Kosovës. Statusi neutral shtroi nevojën për një përzgjedhje se cilat ligje janë të zbatueshme në Kosovë. Praktika gjyqësore e EULEX-it dëshmon se këta të fundit i referoheshin ligjeve të Republikës së Kosovës, rregulloreve të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe ligjeve të ish-Jugosllavisë, në varësi të ndjeshmërisë etnike të rastit dhe vendit të veprimit. Kjo manovër kulmoi në rastin ASC-09-0089, ku gjyqtarët e EULEX-it konsideruan se ligjet e Kosovës të cilat nuk ishin në harmoni me rregulloret e UNMIK-ut janë të pavlefshme. Ky vendim sfidoi jo vetëm Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, por edhe të drejtën e Kuvendit të Kosovës për të nxjerrë ligje të cilat nuk janë në harmoni me rregulloret e UNMIK-ut. Në përgjigje të kësaj, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në rastin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, udhëzoi EULEX-in të zbatonte ligjet e aprovuara pas shpalljes së pavarësisë dhe të mos injoronte shtetshmërinë e Kosovës.<sup>1</sup> Ky tension vazhdoi*

\* PhD kandidat, LLM, Hulumtues Vizitor në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasbourg. Dua të shpreh mirënjohjen e thellë për Luljeta Krasniqin dhe Gresa Bytyqin për komentet dhe redaktimin e këtij shkrimi.

<sup>1</sup> Në gjuhën shqipe, termi *shtetësi* ka kuptim të dyfishtë. Shtetësia përdoret për të treguar lidhjen e qytetarit me shtetin (në anglisht term ekuivalent do të ishte *citizenship*). Gjithashtu, shtetësia nënkupton atributet e krijimit të shtetit (në anglisht term ekuivalent do të ishte *statehood*). Për

*më tutje në rastin SCA-09-0042, ku gjyqtarët e EULEX-it pranuan arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese sa i përket interpretimit të Kushtetutës, por theksuan se kjo e fundit nuk është autoriteti i fundit për interpretimin e detyrimeve që rrjedhin nga Karta e OKB-së. Në vijim, ky punim analizon dialogun gjyqësor ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të EULEX-it, duke u përpjekur të shpalosë sfidat e neutralitetit të këtij të fundit në konsolidimin e shtetshmërisë së Kosovës.*

## 1 Hyrje

Një ditë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, dy organet kryesore politike të OKB-OKB- së dhe Bashkimit Evropian u mblodhën në takime të jashtëzakonshme për të adresuar situatën e krijuar në Kosovë.<sup>2</sup> Në pamundësi të marrjes së një vendimi për njohje apo mosnjohje kolektive, të dy organizatat u pajtuan që të mbesin neutrale ndaj statusit të ri të Kosovës.

Pasojat juridike të statusit neutral mbetën të paqarta. Në fakt, kuptimi i tij mbeti – dhe vazhdon të mbetet – i vagullt, duke dhënë kështu mundësinë e interpretimit të tij në varësi të situatës juridiko-politike.<sup>3</sup>

Në njëërën anë, statusi neutral nuk nënkuptoi shfuqizimin e Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit (KS) të OKB-së, në bazë të së cilës operonte UNMIK-u si dhe organizatat dhe misionet ndërkombëtare të vendosura në Kosovë, duke përfshirë këtu vetë EULEX-in. Në anën tjetër, shpallja e pavarësisë së Kosovës krijoi një realitet të ri, ku kompetencat e ushtruara më parë nga UNMIK-u kaluan përgjithësisht tek institucionet e pavarura të Republikës së Kosovës.

Ndërkohë që UNMIK-u e zvogëloi prezencën e tij në terren, instalimi i misionit të EULEX-it një ditë para shpalljes së pavarësisë e bëri të paqartë bazën juridike me të cilën do të operonin gjyqtarët e këtij misioni në sistemin gjyqësor të Kosovës.<sup>4</sup> Në njëërën anë, operimi i misionit të EULEX-it në Kosovë konsiderohej të jetë nën ombrellën e Rezolutës 1244 (1999) të KS të OKB-së,<sup>5</sup> ndërsa në anën tjetër, gjyqtarët e EULEX-it të cilët funksionojnë si pjesë e integruar në sistemin gjyqësor të Kosovës, operonin ekskluzivisht me ligjet e aprovuara nga Kuvendi i

---

të shmangur këtë konfuzion dhe për qëllime të këtij shkrimi është përdorur termi shtetshmëri si ekuivalent me *statehood*.

<sup>2</sup> Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Takimi 5839, 18 shkurt 2008; Këshilli i Bashkimit Evropian, Përfundimet e Këshillit për Kosovën të dalura nga takimi 2851 i mbajtur në Bruksel, 18 shkurt 2008.

<sup>3</sup> Shih p.sh., si është interpretuar statusi neutral në rastin *Azemi v Serbia* App.No.11209/09 (ECHR 5 November 2013), Vendimi mbi Pranueshmërinë e Lëndës të 5 nëntorit 2013; Kushtrim Istrefi, 'Azemi v Serbia: discontinuity of Serbia's de jure jurisdiction over Kosovo' (2014) 4 *European Human Rights Law Review*, 390-392.

<sup>4</sup> Martina Spornbauer, 'The Difficult Deployment and Challenging Implementation of the Most Comprehensive Civilian EU Operation to Date', (2010) 11 *German Law Journal* 769, 770.

<sup>5</sup> Shih përgjithësisht Erika de Wet, 'The Governance of Kosovo: Security Council Resolution 1244 and the Establishment and Functioning of EULEX', (2009) 103 *American Journal of International Law* 83.

Republikës së Kosovës<sup>6</sup>. Kundrejt këtij realiteti, “jo çuditërisht, kompleksiteti i misionit [të EULEX-it] krijoi vështirësi në konceptimin e ... mandatit dhe operimit [të tij]”.<sup>7</sup>

Kjo krijoi një situatë paradoksale për gjyqtarët e EULEX-it, të cilët përderisa qëndronin neutral ndaj statusit, duhej të vendosnin se cilat ligje janë të zbatueshme në Kosovë. Duke mos paragjykuar statusin politik të Kosovës, gjyqtarët e EULEX-it duhej të vendosnin nëse, në raste të caktuara, duhet të mbizotërojnë ligjet e Republikës së Kosovës, apo rregulloret e UNMIK-ut. Gjithashtu, në kuadër të ushtrimit të kompetencave ekzekutive, gjyqtarët e EULEX-it duhej të vendosnin, në raste specifike, nëse ushtrimi i autoritetit përfundimtar në Kosovë i përkiste institucioneve të Republikës së Kosovës, apo atyre të UNMIK-ut.

Duke i analizuar vendimet gjyqësore të panelit të gjyqtarëve të EULEX-it, si dhe ato të Gjykatës Kushtetuese, ky punim analizon dialogun gjyqësor ndërmjet këtyre dy institucioneve në çështjet që kanë të bëjnë me interpretimin e ligjeve të Republikës së Kosovës dhe rregulloreve të UNMIK-ut. Në analizën e rasteve gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe panelit të gjyqtarëve të EULEX-it, do të preken çështjet që kanë të bëjnë me statusin neutral, shtetshmërinë e Kosovës, hierarkinë e normave ndërmjet Kushtetutës së Kosovës dhe rregulloreve të UNMIK-ut, si dhe garën në ushtrimin e autoritetit final ndërmjet UNMIK-ut, EULEX-it, dhe institucioneve të pavarura të Kosovës.

## **2 Faktet relevante dhe procedimi i rastit para panelit të gjyqtarëve të EULEX-it**

Para shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës mund të hynin në fuqi vetëm pas aprovimit përfundimtar të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (PSSP).<sup>8</sup> Rregulloret dhe udhëzimet administrative të UNMIK-ut nxirreshin ekskluzivisht nga PSSP-ja.<sup>9</sup>

Pas 17 shkurtit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës nxori Kushtetutën dhe ligjet pa kërkuar aprovimin e PSSP-së lidhur me pajtueshmërinë me Rezolutën 1244 (1999) të KS të OKB-së dhe rregulloret e UNMIK-ut.<sup>10</sup> Ky ishte një veprim i

---

<sup>6</sup> Shih p.sh., Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Shih përgjithësisht, Robert Muharremi, ‘The European Union Rule of Law Mission in Kosovo (EULEX) from the Perspective of Kosovo Constitutional Law’ (2010) 70 *ZaöRV*.

<sup>7</sup> Spornbauer, nota 4, në 770.

<sup>8</sup> Rezoluta 1244, UN Doc S/RES/1244; 54 UN SCOR, Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 10 qershor 1999; Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë të 12 dhjetor 1999, e amendamentuar nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese të 15 maj 2001.

<sup>9</sup> Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/1 e 25 korrikut 1999, e amendamentuar.

<sup>10</sup> Nga kjo periudhë kohore, mënyra e miratimit të ligjeve të Kosovës dhe amendamenti i Kushtetutës përcaktohej në nenet, *inter alia*, 80, 81, 144 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

natyrshëm i institucioneve të pavarura të Kosovës të cilat, që nga 17 shkurti 2008, ishin autoriteti më i lartë sovran në vend.

Në maj të vitit 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji për AKP-në).<sup>11</sup> Ligji për AKP-në themeloi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), si “organ të pavarur publik [dhe si] pasardhëse të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12”.<sup>12</sup> Ky ligj shprehimisht kërkoi që të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e AKM-së t’i kalojnë AKP-së.<sup>13</sup> Për më tepër, në nenin 31, paragrafi 1, përcaktohet se Ligji për AKP-në “mbisundon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të”. Paragrafi 2 thotë shprehimisht se “Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, me ndryshimet dhe plotësimet e saj, nuk do të prodhojë efekte juridike pas hyrjes në fuqi të Ligjit për AKP-në”.

Përkundër hyrjes në fuqi të Ligjit për AKP-në dhe themelimit të AKP-së, AKM-ja vazhdoi të ishte e pranishme në kuadër të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, AKM vazhdoi të insistonte se është ajo vetë autoriteti i vetëm dhe i fundit që merret me çështjet e privatizimit në Kosovë.

Paradoksi i bashkë-ekzistencës së AKP-së dhe AKM-së si dhe i legjislacionit të Republikës së Kosovës dhe atij të UNMIK-ut, të paktën në çështjen e privatizimit, jo çuditërisht u ndesh në një proces gjyqësor, ku gjykata duhej të merrte vendim mbi ligjshmërinë e njëres dhe, rrjedhimisht, paligjshmërinë e tjetres.

Meqë për rastet e privatizimit në Kosovë vendos Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila ka një përbërje shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it, çështja e legalitetit në fjalë u mor në shqyrtim pikërisht nga paneli i gjyqtarëve të EULEX-it.

### **3 Aktvendimi i shkallës së parë dhe të dytë i panelit të gjyqtarëve të EULEX-it**

Me themelimin e AKP-së, Agjencia u mor me të gjitha çështjet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë. Ndër të tjera, AKP caktonte listën e punëtorëve legjitimë për të ardhurat nga privatizimi.

Për të sfiduar autoritetin e AKP-së në menaxhimin e procesit të privatizimit, AKM, kërkoi nga paneli i gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që të shpallte të pavlefshme listën e AKP-së lidhur me caktimin e punëtorëve legjitimë për të ardhurat nga privatizimi. AKM argumentoi se lista e AKP-së ishte në mospërputhshmëri me rregulloret dhe udhëzimet administrative të UNMIK-ut.

Në rastin SCCL-09-0003, Trupi Gjyqësor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga paneli i gjyqtarëve të EULEX-it (Trupi Gjyqësor

<sup>11</sup> Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të 21 maj 2008, hyri në fuqi më 15 qershor 2008.

<sup>12</sup> Ibid, neni 5.

<sup>13</sup> Ibid.

i EULEX-it), shpalli të pavlefshme listën e publikuar nga AKP, pezulloi procedurën në këtë rast dhe udhëzoi publikimin e një liste të re në përputhje me ligjin.<sup>14</sup>

Ky aktvendim i Trupit Gjykses të EULEX-it u konfirmua edhe nga Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga paneli i gjyqtarëve të EULEX-it (Kolegji i Ankesave i EULEX-it) në rastin ASC-09-0089.<sup>15</sup>

Kolegji i Ankesave i EULEX-it konstatoi më tej se në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë, është AKM-ja dhe jo AKP-ja ajo që duhet të merret me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë. Ky aktvendim po ashtu thekson se:

Dhoma e Posaçme i pranon aktivitetet e AKP-së si një realitet i qartë për t'iu mundësuar punëtorëve të përfshirë në procesin e privatizimit që të kenë qasje efektive në gjykatë në kuptim të nenit 6 të [Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut]. Kjo nuk do të thotë dhe nuk mund të thotë se Dhoma e Posaçme e pranon Ligjin e AKP-së si ligj në fuqi në Kosovë.

Në fund, kërkohet që lista e punëtorëve të publikohet në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12.

Është e rëndësishme të theksohet se para marrjes së aktvendimit në fjalë, Kryesuesi i Kolegjit të Ankesave të EULEX-it kërkoi nga PSSP-ja të ofronte sqarime për, *inter alia*, ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12, mbi çështjet që kanë të bëjnë me AKM-në, AKP-në dhe për ligjin e zbatueshëm në Kosovë. Më saktësisht, në këtë listë pyetjesh kërkoi nga PSSP-ja mendimin e tij nëse AKP-ja mund të trajtohet si "Agjenci", në përputhje me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2008/4.

Në përgjigjen e PSSP-së të datës 12 nëntor 2009, ky i fundit argumentoi se:

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12, e cila e themeloi AKM-në, mbeti në fuqi dhe zbatohet në Kosovë në bazëtë Rezolutës 1244 ..., dhe se ajo mund të anulohet apo ndryshohet vetëm nëpërmjet një rregulloreje tjetër të UNMIK-ut, gjë e cila nuk ka ndodhur.<sup>16</sup>

Kjo letër tutje theksoi se:

Ligji [për AKP-në]...pa u shpallur nga një rregullore e UNMIK-ut dhe duke pretenduar të ketë hyrë në fuqi me 15 qershor 2008, nuk mund të heqë apo anulojë Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 e as ta shuajë ekzistencën ligjore tëAKM-së si Agjenci e pavarur me personalitet të plotë juridik.

PSSP konstatoi se AKP "më së miri mund të konsiderohet të veprojë si agjent i

<sup>14</sup> Aktvendimi SCEL-09-0003 i Trupit Gjykses të panelit të gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 21 tetor 2009.

<sup>15</sup> Aktvendimi ASC-09-0089 i Kolegjit të Ankesave të panelit të gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 4 shkurt 2010.

<sup>16</sup> Marrë nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykimi në rastin KI 25/10, 31 mars 2011, paragrafi 21.

AKM-së duke operuar pa aprovimin dhe autoritetin e AKM-së/UNMIK-ut”.<sup>17</sup> Duke njohur kompetencat e PSSP-së dhe bazën ligjore mbi të cilën operon AKM, dikush mund të argumentojë me të drejtë se Kolegji i Ankesave i EULEX-it e përdori PSSP-në për të sforcuar qëndrimin e saj në rastin e parë dhe të dytë. Përgjithësisht, nëse analizohet aktvendimi i Kolegjit të Ankesave të EULEX-it dhe mendimi i PSSP-së, vërehet një përputhshmëri e plotë mes tyre, duke lënë kështu të kuptohet se kjo e fundit e kishte influencuar aktvendimin e Kolegjit të Ankesave të EULEX-it.

#### 4 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

Vendimi i Kolegjit të Ankesave të EULEX-it paraqet një rëndësi të veçantë jo vetëm për çështjen e ngushtë të shqyrtimit të privatizimit. Është evidente se rasti ASC-09-0089 sfidon mbi të gjitha Kushtetutën, ligjet e Kosovës të miratuara nga Kuvendi dhe autoritetin e institucioneve të pavarura të Kosovës, për të qeverisur vendin karshi prezencës së UNMIK-ut dhe legjislacionit të tij.

Për të shqyrtuar aspektet e kushtetutshmërisë së këtij aktvendimi, AKP, në cilësinë e parashtruesit të lëndës, kërkoi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (Gjykata Kushtetuese), të vlerësojë, *inter alia*, nëse: 1) kolegji i Apelit shkeli të drejtën e AKP-së për gjykim nga një gjykatë e pavarur, kur kërkoi sqarim nga PSSP-ja, dhe në të njëjtën kohë nuk i ofroi AKP-së mundësinë për t'u përgjigjur lidhur me këtë sqarim; 2) kolegji i Apelit shkeli Kushtetutën dhe ligjin, kur refuzoi njohjen e Ligjit për AKP-në si ligj në fuqi; 3) neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/24 është në kundërshtim me nenin 145 të Kushtetutës.

Nga pikëpamja e Kushtetutës dhe në përputhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, kjo e fundit është dashur të sqaronte nëse Ligji për AKP-në ishte miratuar në mënyrë të ligjshme nga Kuvendi i Kosovës dhe nëse ky i fundit ka mandat për të nxjerrë ligje që shfuqizojnë Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12, të ndryshuar, lidhur me themelimin e AKM-së.

Në përgjigje, Gjykata Kushtetuese në rastin KI 25/10 theksoi:

Në pajtim me nenin 145 [të Kushtetutës], rregulloret dhe udhëzimet administrative të [UNMIK-ut], si dhe legjislacioni tjetër do të vazhdojnë të zbatohen vetëm për aq sa janë në pajtim me Kushtetutën derisa të shfuqizohen, zëvendësohen apo ndryshohen në pajtim me Kushtetutën.

Prandaj, rregulloret e UNMIK-ut dhe udhëzimet administrative relevante vazhdojnë të jenë të zbatueshme vetëm për aq sa janë në pajtueshmëri me Ligjin [për AKP-në]. (para 59)

Në këto rrethana, ... Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, në vendimin e saj ASC-09-089, qartazi “nuk ka siguruar zbatimin e njëtrajtshëm të Ligjit”, siç parashihet me Propozimin Gjithëpërfshirës [të Ahtisarit], gjithashtu nuk ka vepruar në pajtim me obligimet e parapara në nenin ... 102 [3] të Kushtetutës, pasi që ... nuk e konsideron [Ligjin për AKP-në] si ligj, drejtësisht i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, por si rregulla te brendshme të vlefshme dhe të detyrueshme të organizatës së AKP-së, që e karakterizoi si

<sup>17</sup> Ibid.

organizatë faktike, në vend të një organi publik të pavarur me zotësi të plotë juridike, siç është parashtruar në Ligjin [për AKP].<sup>18</sup>

Sipas qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese, zanafilla e kësaj problematike qëndron në faktin se:

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk njeh dhe zbaton ligjet e miratuara ligjërisht nga Kuvendi. Në fakt, Dhoma e Posaçme thjeshtë vazhdon ta injorojë ekzistimin e Kosovës si shtet të pavarur dhe ligjet që burojnë nga Kuvendi i saj.<sup>19</sup>

Gjykata Kushtetuese më tej u rikujtoi gjyqtarëve të EULEX-it qëndrimin e tyre paradoksal lidhur me përzgjedhjen e ligjit të zbatueshëm në Kosovë. Aktgjykimi thekson:

[është e] paimagjinueshme se gjyqtarët e EULEX-it të integruar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në pajtim me Ligjin [mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë] refuzojnë të zbatojnë ligjet e miratuara sipas rregullit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.<sup>20</sup>

Meqë rasti në fjalë preku çështjet e respektimit, nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it, jo vetëm të Kushtetutës dhe ligjeve, por edhe të shtetshmërisë së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e konsideroi të arsyeshme t'i referohet edhe Mendimit Këshilldhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në rastin e Kosovës. Gjykata Kushtetuese arsyetoi se:

themelimi i Republikës së Kosovës si shtet i pavarur, sipas deklaratës së pavarësisë dhe shtetësia e së cilës ishte njohur, deri më tani, nga [në atë kohë] 75 shtete, prandaj nuk është në kundërshtim me Rezolutën ... 1244 si dhe të drejtën ndërkombëtare, parimeve që duhet t'iu përmbahet Republika e Kosovës, siç është parashtruar në nenin 16 (3) të Kushtetutës, që përcakton se "Republika e Kosovës respekton të drejtën ndërkombëtare".<sup>21</sup>

Edhe pse mund të konsiderohet se me vendimin ASC-09-0000, gjyqtarët e EULEX-it nuk kanë respektuar pasojat që krijoi pavarësia e Kosovës, mbetet e kontestueshme nëse është dashur që Gjykata Kushtetuese t'i referohet Mendimit Këshilldhënës të GJND-së për të "arsyetuar" apo "konfirmuar" ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës.<sup>22</sup> Paragrafi i cituar më lartë, jep përshtypjen se Gjykata Kushtetuese ndjeu nevojën të tregojë përputhshmërinë e Rezolutës 1244 (1999) me pavarësinë e Kosovës dhe legjislacionin e krijuar pas shpalljes së saj, më 17 shkurt 2008.

<sup>18</sup> Ibid, paragrafi 58-60. Neni 102(3) thotë: Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

<sup>19</sup> Ibid, paragrafi 53.

<sup>20</sup> Ibid, paragrafi 61.

<sup>21</sup> *Accordance with international law of the unilateral declaration of independence in respect of Kosovo*, Mendimi Këshilldhënës, Raportet e GJND-së 2010, 10 qershor 2010, paragrafi 54.

<sup>22</sup> Kushtrim Istrefi, *Oxford Reports on International Law ILDC 1606 (KO 2011)*, 8 prill 2013, OUP.

Edhe pse Mendimi Këshilldhënës i GJND-së kryesisht fokusohet në Deklaratën e Pavarësisë dhe jo në pasojat juridike të saj, referimi në të vetëm sa mund të vështirësojë relevancën e saj. Për më tepër për faktin se në paragrafin 88 të Mendimit Këshilldhënës, GJND megjithatë theksoi:

rregulloret e UNMIK-ut ... të aprovuara nga [PSSP] në bazë të autoritetit të deleguar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit ... dhe rrjedhimisht nga Karta e OKB-së ... posedojnë karakterin dhe [detyrimin] e të drejtës ndërkombëtare.

Në bazë të këtij Mendimi Këshilldhënës, mbetet e vështirë për t'u përgjigjur nga perspektiva e të drejtës ndërkombëtare nëse rregulloret e UNMIK-ut, si legjislacion i karakterit ndërkombëtar dhe si pjesë e obligueshme e të drejtës ndërkombëtare, mund të shfuqizohen nëpërmjet të drejtës vendore, respektivisht ligjeve të Kuvendit të Kosovës. Rrjedhimisht, meqë objekti i gjykimit të Gjykatës Kushtetuese ishte i lidhur me raportin ndërmjet Kushtetutës, ligjeve të Kosovës dhe rregulloret e UNMIK-ut, referimi në Mendimin Këshilldhënës të GJND-së, jo detyrimisht mund të shihet si pozitiv për të forcuar argumentimin. Gjykata Kushtetuese, si produkt i pavarësisë së Kosovës, në parim nuk ka pasur nevojë të aktivizojë të drejtën ndërkombëtare për të arsyetuar *primum verum*, respektivisht të vërtetën e parë, atë të ekzistimit të shtetit të Kosovës dhe ligjshmërisë së shtetshmërisë së saj.

Sidoqoftë, duke rikujtuar realitetin politiko-juridik në të cilin veprojnë gjyqtarët e EULEX-it, dikush mund të arsyetojë se referimi në Mendimin e GJND-së ishte një *obiter dictum*, i cili ka kontribuar në krijimin e një raporti harmonizues dhe jo-konfliktual ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të EULEX-it. Nëpërmjet këtij arsyetimi deduktiv, duket se Gjykata Kushtetuese ka dashur t'i udhëzojë gjyqtarët e EULEX-it, se Deklarata e Pavarësisë nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244 (1999) dhe se ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës janë në harmoni me të edhe në rastet kur shfuqizojnë Rregulloret e UNMIK-ut.

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese e shpalli të pavlefshëm vendimin ASC-09-089, të gjyqtarëve të EULEX-it dhe të njëjtin vendim e ktheu për shqyrtim në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

## **5 Vendimi i radhës i EULEX-it: vazhdimi apo fundi i “sagës”?**

Në vendimin SCA-09-0042, të 29 nëntorit 2012, paneli i gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme pranoi se Ligji për AKP-në është ligj i zbatueshëm dhe se në bazë të nenit 112(1) të Kushtetutës është i obligueshëm nga aktgjykimi KI 25/10 i Gjykatës Kushtetuese.<sup>23</sup>

<sup>23</sup> Aktvendimi SCA-09-0042 i Kolegjit të Ankesave të panelit të gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 29 nëntor 2012, f 4.



Megjithatë, paneli i gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme konsideroi se arsyetimi i Gjykatës Kushtetuese është i obligueshëm vetëm sa i përket interpretimit të ligjeve të Kosovës, por jo edhe të së drejtës së OKB-së.<sup>24</sup>

Duke kufizuar autoritetin e Gjykatës Kushtetuese vetëm në interpretimin e ligjeve të Kosovës, paneli i gjyqtarëve të EULEX-it u mundua të krijojë *domaine réservée* sa i përket interpretimit të së drejtës së OKB-së. Kësisoj, Dhoma e Posaçme theksoi se:

Në bazë të fuqisë së Kapitullit VII, Këshilli i Sigurimit më 10 qershor 1999 aprovoi Rezolutën 1244 e cila e vendosi Kosovën nën administrimin e ... UNMIK-ut. Që nga ajo kohë, UNMIK-u e administroi Kosovën nëpërmjet një sërë rregulloresh, përfshirë, ndër të tjera, Rregulloren 2002/13 ... "Mbi Themelimin e ... AKM-së", e cila e mveshi AKM-në me autoritetin dhe përgjegjësinë për administrimin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërore. Kjo nënkuptoi edhe kompetencën për përfaqësimin e ndërmarrjeve të tilla. Më 17.02.2008 Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e Kosovës. Ky akt nuk pati asnjë ndikim në ligjshmërinë dhe aplikueshmërinë e ligjit të nxjerrë nën autoritetin e OKB-së. Ligji i OKB-së nuk varet nga pranueshmëria e adresantit. Të gjitha vendet, përfshirë edhe ato që asnjëherë nuk kanë pasur shtetshmëri të kontestuar, i nënshtrohen ligjit të OKB-së. Prandaj, mendimi i Gjykatës Kushtetuese për konfliktin e ligjit të OKB-së me pavarësinë e Kosovës ... tregon për keqkuptimin e të drejtës së OKB-së.<sup>25</sup>

Në bazë të kësaj, mbetet e kontestueshme që EULEX-i, dhe jo Gjykata Kushtetuese, është autoriteti përfundimtar në interpretimin e të drejtës ndërkombëtare në Kosovë. Është e rëndësishme të theksohet se paneli i gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme nuk iu referua asnjë dispozite ligjore vendore ose ndërkombëtare kur bëri këtë konstatim.

Gjithashtu, qëndrimi i panelit të gjyqtarëve të EULEX-it se e drejta e OKB-së obligon edhe vendet jo-anëtare, nuk ishte i mbështetur me asnjë referencë ligjore. Është e vërtetë se në të kaluarën Këshilli i Sigurimit i ka bërë thirrje vendeve jo-anëtare të OKB-së të zbatojnë detyrimet e saj duke iu referuar neni 2(6) të Kartës së OKB-së.<sup>26</sup> Sipas Hans Kelzenit, neni 2(6) i Kartës paraqet "parim revolucionar" që bën përjashtim në rregullën e traktateve *pacta tertiis*, pasi që i obligon vendet jo-anëtare të OKB-së në çështjet që kanë të bëjnë me paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.<sup>27</sup> Sidoqoftë, shumica e autorëve, shtetet jo-anëtare dhe gjykatat rajonale, konsiderojnë se neni 2(6) i Kartës nuk i obligon vendet jo-anëtare të OKB-së.<sup>28</sup>

<sup>24</sup> Ibid. në 4.

<sup>25</sup> Ibid.

<sup>26</sup> Shih paragrafin 2 të Rezolutës 314 mbi Rodezinë Jugore të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 28 shkurt 1972.

<sup>27</sup> H Kelsen *The Law of the United Nations: a Critical Analysis of its Fundamental Problems* (Stevens 1950), në 110.

<sup>28</sup> S Talmon, 'Article 2.6' in Bruno Simma and ors (eds), *The Charter of the United Nations: A Commentary* (3<sup>rd</sup> edn, Oxford University Press 2012), në 255; MC Krafft, D Thürer, dhe JA Stadelhofer, 'Switzerland', në V Gowlland-Debbas (ed), *National Implementation of United Nations Sanctions: A Comparative Study* (Martinus Nijhoff 2004) në 523, 525-6. Për rastet gjyqësore shih p.sh. T-85/09 *Kadi v Commission* [2010] ECR II-05177.

Duke komentuar nenin 2(6) të Kartës së OKB-së, Stefan Talmon argumenton se vendet jo-anëtare të OKB-së “nuk mund të obligohen nga detyrimet e Kartës në të cilën nuk janë anëtare, përveç nëse detyrimi i Kartës paraqet obligim të së drejtës ndërkombëtare zakonore”.<sup>29</sup> Lidhur me këtë çështje, është e rëndësishme të rikujtojmë se para anëtarësimit të Zvicrës në OKB, qeveria e saj mori qëndrimin se Zvicra nuk ka obligim ligjor të marrë pjesë në regjimin e sanksioneve të OKB-së, mirëpo, pavarësisht kësaj, ajo ka vendosur të marrë pjesë në mënyrë të pavarur dhe vullnetare (*autonomer Nachvollzug*).<sup>30</sup> Gjithashtu, praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE) na ofron një qëndrim të ngjashëm lidhur me obligimet e Kartës për vendet jo-anëtare. Në rastin *Kadi*, GJDBE kishte konstatuar se “korniza kushtetuese e krijuar nga Traktati i Komunitetit Evropian si sistem juridik krejtësisht autonom nuk është subjekt i ... të drejtës që derivon nga Karta e Kombeve të Bashkuara”.<sup>31</sup>

Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme që mund të ekzistojnë lidhur me këtë çështje, do të ishte më bindëse nëse paneli i gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme do të arrinte në përfundimin e saj, duke iu referuar ndonjë dispozite të së drejtës vendore ose ndërkombëtare.

Në paragrafin e cituar më lart, të Dhomës së Posaçme, kjo e fundit po ashtu theksoi se “Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e Kosovës”.<sup>32</sup> Duke provuar të regjistrojë një ngjarje faktike, paneli i gjyqtarëve të EULEX-it gabimisht vlerësoi se cilët janë autorët e pavarësisë së Kosovës. Çështja e autorëve të pavarësisë së Kosovës ka qenë pjesë qendrore e Mendimit Këshilldhënës të GJND-së.<sup>33</sup> GJND-së i ishte kërkuar të sqarojë nëse Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 ishte nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës, duke vepruar nën kornizën e institucioneve të përkohshme të vetë-qeverisjes në Kosovë dhe rrjedhimisht nën Kornizën Kushtetuese të UNMIK-ut, apo, nëse Deklarata e Pavarësisë ishte nxjerrë nga përfaqësuesit e popullit të Kosovës, të cilët vepronin jashtë kornizës ligjore të UNMIK-ut. GJND-ja mbajti qëndrimin se autorët e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës ishin përfaqësuesit e popullit të Kosovës dhe jo Kuvendi i Kosovës. Në vijim të kësaj, dhe meqë Dhoma e Posaçme bëri arsyetimin e saj ekskluzivisht duke u thirrur në të drejtën ndërkombëtare, dhe më saktësisht të së drejtës së OKB-së, do të duhej që ajo të ishte treguar më e kujdesshme dhe

<sup>29</sup> Talmon, nota 28, në 255.

<sup>30</sup> MC Krafft, D Thürer, and JA Stadelhofer, nota 28, në 523, 525–6.

<sup>31</sup> *Kadi v Commission* [2010], nota 28, paragrafi 119. Përshkrim i përgjithshëm që Gjykata e Përgjithshme e BE-së i bën vendimit të GJDBE-së në rastin *C-402/05 P dhe C-415/05 P Kadi and Yusuf v Council dhe Commission* [2008] ECR I-6351. Shih gjithashtu Gráinne de Búrca, ‘The European Court of Justice and the International Legal Order After Kadi’ (2010) 51 HILJ 4; Kushtrim Istrefi, ‘The Application of Article 103 of the United Nations Charter in the European Courts: the Quest for Regime Compatibility on Fundamental Rights’, (2013) 5 *European Journal of Legal Studies* 86-89.

<sup>32</sup> Aktvendimi SCA-09-0042, nota 23, f 4.

<sup>33</sup> *Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo*, nota 21, f 403; Shih Kushtrim Istrefi, *Oxford Reports on International Law ILDC 2089 (XK 2012)*, 6 janar 2014, OUP.

ligjërishit më e saktë, kur iu referua autorëve të pavarësisë së Kosovës.

Duke lënë mënjanë tensionin e këtij dialogu gjyqësor sa i përket autoritetit dhe interpretimit të së drejtës ndërkombëtare, dhe pakujdesisë në konstatimet lidhur me autorët e pavarësisë së Kosovës, në fund, paneli i gjyqtarëve të EULEX-it doli në përfundime të njëjta me ato të Gjykatës Kushtetuese. Në konkluzionin e saj, Dhoma e Posaçme konstatoi se:

në pamundësi të Këshillit të Sigurimit të zgjidhë statusin e Kosovës dhe në pamundësi të UNMIK-ut për të administruar Kosovën ..., vendimet e legjislaturës së Kosovës tani janë të ligjshme edhe në rast se hyjnë në konflikt me Rregulloret e OKB-së, më herët të aprovuara nga UNMIK-u.<sup>34</sup>

Dhoma e Posaçme doli në këtë përfundim vetëm pasi vlerësoi se UNMIK-u ka dështuar të nxjerrë ligje dhe të administrojë Kosovën, përfshirë çështjet e privatizimit, që nga qershori 2008.<sup>35</sup> Në vijim të kësaj, paneli i gjyqtarëve të EULEX-it konstatoi se “në nivel të UNMIK-ut, administrimi i përkohshëm ka përfunduar... [edhe përkundër faktit] se Rezoluta 1244 nuk ka limit kohor”.<sup>36</sup> Me po këtë arsytim Dhoma e Posaçme vërtetoi se “aplikueshmëria e Rregullores 2002/12 ... ka përfunduar”.<sup>37</sup>

Edhe në këtë pjesë, arsytimi i Dhomës së Posaçme nuk pati ndonjë referencë ligjore, kur vendosi për përfundimin e Rregullores së UNMIK-ut dhe administrimin e saj në Kosovë.

Edhe pse një qëndrim i tillë reflekton gjendjen në terren, në aspektin e arsytimit ligjor mbetet e kontestueshme nëse paneli i gjyqtarëve të EULEX-it ka mandat të bëjë interpretim autoritativ të së drejtës që buron nga Karta e OKB-së. Në këtë çështje, Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë, në rastin *Jaçorzina* kishte theksuar se “është parim i njohur se e drejta e interpretimit autoritativ të një rregulle ligjore i takon vetëm personit ose trupit i cili ka mandat për ta ndryshuar ose shfuqizuar atë”.<sup>38</sup> Sipas Michael Wood, “vetëm Këshilli i Sigurimit, ose ndonjë trupë e autorizuar nga Këshilli, mund të bëjë interpretim autentik në kuptimin e plotë”.<sup>39</sup> Duke u bazuar në linjën e argumentimit të së drejtës ndërkombëtare, mbetet e diskutueshme nëse gjyqtarët e EULEX-it kanë autoritet të vendosin në mënyrë të pavarur rreth përfundimit të administrimit të UNMIK-ut dhe moszbatueshmërisë së rregulloreve të saj.<sup>40</sup> Ndoshta, argumenti se gjyqtarët e EULEX-it veprojnë me autorizimin e Këshillit të Sigurimit mund të

<sup>34</sup> Aktvendimi SCA-09-0042, nota 23, f 5.

<sup>35</sup> Ibid, f 4.

<sup>36</sup> Ibid.

<sup>37</sup> Ibid.

<sup>38</sup> Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë, *Delimitation of the Polish-Czechoslovakian Frontier (Question of Jaworzina)*, Mendimi Këshilldhënës (1923), PCIJ Series B, No 8, paragrafi 80, 6 dhjetor 1923.

<sup>39</sup> Michael C. Wood, ‘The Interpretation of Security Council Resolutions’, (1998) 2 Max Planck Yearbook of United Nations Law 82.

<sup>40</sup> Istrefi, nota 33.

arsyetojë qëndrimet e Dhomës së Posaçme. Sidoqoftë, në mungesë të referimeve ligjore, çdo argumentim që arsyeton gjetjet e Dhomës së Posaçme mbetet hipotetik.

Me gjasë, pamundësia e argumentimit në frymën e ligjit dhe përfundimet mbi gjendjen faktike reflektojnë për një sfidë të paprecedentë edhe për vetë gjyqtarët e EULEX-it, të cilët, në njërën anë kishin mendimin e PSSP-së dhe, në anën tjetër kishin aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, qëndrime këto të cilat udhëzojnë për veprime diametralisht të kundërta. Për të dalë nga ky ngërç, Dhoma e Posaçme vlerësoi me të drejtë “se përderisa UNMIK-u dështoi në administrimin e Kosovës, popullsia në Kosovë kishte nevojë për një status të ri dhe një administratë dhe legjislacion të azhurnuar”.<sup>41</sup>

Ky përfundim duket se dëfton dhe ilustron për një nevojë të njohjes së sistemit juridik të Kosovës, me qëllim mbulimin e zbrazëtisë juridike të krijuar nga ndryshimi i sistemeve juridike. Kështu, Dhoma e Posaçme u mundua të arsyetojë vendimin e saj më tepër në bazën e një realiteti të krijuar në terren, sesa të një argumentimi ortodoks qoftë të së drejtës ndërkombëtare, qoftë të asaj kushtetuese.

## 6 Përfundim

Wolfgang Koeth, në shkrimin e tij “Shtetndërtimi pa Shtet” vë në dukje relacionin e çuditshëm të Bashkimit Evropian me Republikën e Kosovës.<sup>42</sup> Në këtë kontekst, vetë operimi i misionit të EULEX-it, i cili, në njërën anë është përkushtuar të ndihmojë shtetndërtimin e Kosovës dhe, në anën tjetër, të qëndrojë neutral karshi statusit të saj politik, dëshmon për një veprim kundërthënës.

Duke analizuar disa vendime specifike të gjyqtarëve të EULEX-it, ky kontribut pasqyroi se qëndrimi neutral ndaj statusit ka bërë që këta të fundit, në raste të caktuara, të pengojnë procesin e konsolidimit të shtetit të Kosovës dhe të kontestojnë efektet e pavarësisë së Kosovës në habitatin e saj.

Këto raste gjëqësore pasqyruan një dialog të tensionuar gjyqësor ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të EULEX-it. Vendimet e EULEX-it sfiduan hapur rendin kushtetues dhe ekzistencën e shtetit të Kosovës. Një tension i tillë nuk duket të jetë krijuar vetëm si rezultat i dallimeve që mund të ekzistojnë në interpretimet ortodokse të së drejtës së OKB-së dhe prezencës së UNMIK-ut në Kosovë.

Në kundërpërgjigje, Gjykata Kushtetuese luajti një rol të paprecedent në mbrojtjen jo vetëm të kushtetutshmërisë, por dhe të ligjshmërisë së shtetshmërisë së Kosovës. Duke bërë këtë, Gjykata Kushtetuese udhëzoi gjyqtarët e EULEX-it – dhe nëpërmjet kësaj edhe autoritetet e tjera ndërkombëtare që operojnë në Kosovë në kartën e *neutralitetit* – që të respektojnë Kushtetutën dhe

<sup>41</sup> Aktvendimi SCA-09-0042, nota 23, f 4.

<sup>42</sup> Wolfgang Koeth, ‘State Building without a State: The EU’s Dilemma in Defining Its Relations with Kosovo’ (2010) 15 *European Foreign Affairs Review*, 227-247.

ligjet e Kosovës sikundër autoritetet e pavarura të Kosovës në ushtrimin e funksioneve të tyre shtetërore.

Si duket kjo “sagë” përfundoi me respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës edhe kur ato nuk janë në harmoni me rregulloret e UNMIK-ut. Duke pranuar Ligjin mbi AKP-në dhe duke vendosur mbi përfundimin e Rregullores së UNMIK-ut 2002/12, vendimi i fundit i panelit të gjyqtarëve të EULEX-it mund të konsiderohet se ka gjetur një *modus vivendi* i cili arriti të zbuste tensionin e krijuar.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Dhoma e Posaçme, gjithashtu ndërroi emrin e saj nga “Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”, në “Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit”.<sup>43</sup> Rëndësia e këtij ndryshimi nuk konsiston vetëm në simbolikën gjuhësore, por edhe në semantikën e saj. “Gara” ndërmjet UNMIK-ut dhe institucioneve të pavarura të Kosovës në ushtrimin e autoritetit përfundimtar në vend rezultoi me njohjen nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it të sistemit dhe institucioneve të Republikës së Kosovës dhe mosnjohjen e atyre të UNMIK-ut.

Përkundër kësaj, rruga e ndryshme e argumentimit që u zbatua nga Gjykata Kushtetuese dhe gjyqtarët e EULEX-it lidhur me rolin e së drejtës së OKB-së në Kosovë, dëshmon se këta të fundit ende thirren në kartën e neutralitetit. Megjithatë, detyrimi i veprimit të gjyqtarëve të EULEX-it konform legjislacionit dhe autoriteteve të pavarura të Kosovës, dhe qëndrimi se legjislacioni i UNMIK-ut ka mbaruar, tregon për një neutralitet që nuk është armiqësor ndaj shtetshmërisë së Kosovës. Kësisoj, edhe vet kuptimi i *neutralitetit* do të vazhdojë të formësohet dhe kuptohet – si çështje në progres – në varësi të rrethanave të krijuara juridiko-politike.

---

<sup>43</sup> Krahaso p.sh., Aktvendimim ASC-10-0002 i Kolegjit të Ankesave të panelit të gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 8 mars 2010, i aksesueshëm në [http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/civil-proceedings/SC-KTA/ASC-10-0002\\_EN\\_20100309\\_final\\_Decision\\_an.pdf](http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/civil-proceedings/SC-KTA/ASC-10-0002_EN_20100309_final_Decision_an.pdf), me Aktvendimin SCEL -10-0010 e Trupit Gjykues të panelit të gjyqtarëve të EULEX-it të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 15 maj 2013, i aksesueshëm në <http://www.eulex-kosovo.eu/docs/justice/judgments/civil-proceedings/SC-KTA/2013/SCEL-10-0010/SCEL-10-0010-%20ENG%20-%20Judgment.pdf>.